



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1442 / 5 prot.

Vlorë, më 23 . 11 .2018

VENDIM

Nr. 81, datë 23.11.2018

**PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT
"BACHELOR NË MATEMATIKË-FIZIKË"**

Mbështetur në nenin **73**, pikën **7** të nenit **25**, shkronjën **dh**, pika **1** në nenin **38** në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 23.11.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Fizikës për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në matematikë-fizikë".
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

